

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE TREGTARE  
“LucentLine Solutions” Sh.p.k**

Më datë 12.03.2021, në qytetin e Tiranës është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**LucentLine Solutions**” Sh.p.k.

Themelues i shoqërisë është ortak i vetëm:

**Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Tish Dahia, Pallati Eurobises, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I21029038M.

**NENI 1  
KUADRI LIGJOR**

Shoqëria “**LucentLine Solutions**” Sh.p.k është person juridik shqiptar dhe funksion në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**NENI 2  
EMERTIMI**

Emërtimi i shoqërisë është “**LucentLine Solutions**” Sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k .

**NENI 3  
SELIA E SHOQERISE**

1. Shoqëria e ka selinë në qytetin e Tiranës, në adresën: Rruga: “**Tish Daija,Kompleksi Kika 2**”, Tiranë.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të ortakëve të saj .

**NENI 4  
KOHEZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është për një afat të pacaktuar.
2. Në përputhje me parashikimet e statutit, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj, ose mund ta zgjasë kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.



**NENI 5**  
**QELLIMI DHE OBJEKTI**

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “**LucentLine Solutions**” Sh.p.k. do të jenë aktivitete të lidhura kryesisht me: Call Center. Shërbime apo veprimtari të cdo lloji nëpërmjet telefonit për llogari të vet apo të të treteve, që nuk bien ndesh me ligjet shqiptare në fuqi.

**NENI 6**  
**KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar është fiksuar në 100,000 lekë. (njëqind mijë lekë). Ai mund të rritet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.
2. Kapitali ndahet në 1 kuotë me vlerë totale 100,000 lekë. (njëqind mijë lekë).

**NENI 7**  
**KUOTAT**

Kuotat e pjesëmarrjes janë:

1 kuotë me vlerën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit në zotërim të **Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga Tish Dahia, Pallati Eurobisnes, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi: I21029038M.

**NENI 8**  
**ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

**1. Asambleja e Përgjithshme :**

Asambleja e përgjithshme krijohet nga ortakët themelues:

**Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga Tish Dahia, Pallati Eurobisnes, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I21029038M.

**2. Administratori :**



Administratori i shoqërisë zgjidhet për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ripërtëritje **Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga Tish Dahia, Pallati Eurobisnes, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I21029038M.

#### **NENI 9**

#### **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI**

Shoqëria do të organizohet dhe do të funksionojë në bazë të parashikimeve të përcaktuara në statut.

#### **NENI 10**

#### **LIGJI I APLIKUESHEM**

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe cdo bazë ligjore të parashikuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

#### **NENI 11**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Palët e interesuara kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kompetente për cdo kundërshtim që kanë rreth aktivitetit të shoqërisë.

#### **NENI 12**

#### **DISPOZITA KALIMTARE**

Ky akt themelimi hyn në fuqi nga data e miratimit dhe regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Akt themelimi u përpilua në dy kopje në gjuhën shqipe .

#### **ORTAKET THEMELUES**

**Lorenc Xhepa**



**STATUT**  
**I SHOQERISE TREGTARE**  
**“LucentLine Solutions” Sh.p.k.**

**KAPITULLI I**  
**KRIJIMI, FORMA, QELLIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI, SELIA**

**NENI 1**  
**KRIJIMI I SHOQËRISE**

1. Më datë 12.03.2021 , në qytetin e Tiranës është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“LucentLine Solutions” Sh.p.k.** (më poshtë referuar si “shoqëria”).
2. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” .
3. Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar që prej datës në të cilën Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka dhënë aprovimin për themelimin e saj.
4. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese (Akt Themelimi dhe Statuti).

**NENI 2**  
**FORMA E SHOQËRISE**

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që ortakët e kësaj shoqërie nuk do të marrin një vendim për ndryshimin e formës së saj ligjore.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**NENI 3**  
**ORTAKET**

Shoqëria krijohet nga ortakët si më poshtë :

**Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Tish Dalia, Pallati Eurobisnes, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I21029038M.

**NENI 4**  
**EMËRTIMI**

Emërtimi i shkurtër i shoqërisë është **“LucentLine Solutions” Sh.p.k.** Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose inicialet Sh.p.k .

**NENI 5**



## SELIA E SHOQERISE

1. Shoqëria e ka selinë në qytetin e Tiranës, në adresën: Rruga: Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të ortakëve të saj.

### NENI 6 KOHEZGJATJA

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është për një afat të pacaktuar.
2. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj, ose mund ta zgjasë kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

### NENI 7 QELLIMI DHE OBJEKTI

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “**LucentLine Solutions**” Sh.p.k. do të jenë aktivitete të lidhura kryesisht me: Call Center. Shërbime apo veprimtari të cdo lloji nëpërmjet telefonit për llogari të vet apo të të tremeve, që nuk bien ndesh me ligjet shqiptare në fuqi.

## KAPITULLI I I

### KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

#### NENI 8 KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar është fiksuar në 100,000 lekë. (njëqind mijë lekë). Ai mund të rritet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.
2. Kapitali ndahet në 1 kuotë me vlerë totale 100,000 lekë. (njëqind mijë lekë).

#### NENI 9 KUOTAT

Kuotat e pjesëmarrjes janë:

1 kuotë me vlerën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit në zotërim të **Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Tish Dahia, Pallati Eurobisnes, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : 121029038M.

#### NENI 10



## MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit shoqërisë, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a. Kontributit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë;
  - b. Shitblerjes;
  - c. Trashëgimisë;
  - d. Dhurimit;
  - e. Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

### NENI 11

#### PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e përfiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 te nenit 74 te Ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008.
2. Shoqëria realizon kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

### KAPITULLI I I I

#### MARREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

### NENI 12

#### SHPERNDARJA E FITIMEVE

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë sipas përqindjes së pjesëmarrjes në shoqëri, pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë dhe të miratuara prej asamblesë së ortakëve.
2. Administratori i shoqërisë në rastin e shpërndarjes së fitimit duhet që dokumentin përkatës që autorizon strukturën përkatëse për kalimin e fitimeve ndaj ortakëve të shoqërisë, ta shoqërojë me vendimin përkatës të asamblesë, i cili miraton në parim shpërndarjen e fitimeve.

### NENI 13

#### KUFIZIMET E SHPERNDARJES, ÇERTIFIKATA E AFTESISE PAGUESE, PERGJEGJESITE

1. Shoqëria mund t’u shpërndajë fitim ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
  - a. Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12-muajve në vazhdim.
  - c. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.



2. Administratori lëshon një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e paragrafit të parë të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund të lëshojë këtë çertifikatë .
3. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e çertifikatës së aftësisë paguese.
4. Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një çertifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.
5. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividend, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, pavarësisht lëshimit të certifikatës, nëse këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë sipas paragrafit të parë të këtij neni.

## KAPITULLI IV ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

### NENI 14

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

#### 1. Asambleja e Përgjithshme e cila përbëhet nga:

**Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Tish Dahia, Pallati Eurobisnes, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I21029038M.

#### 2. Administratori :

Administratori i shoqërisë zgjidhet për një afat pesëvjeçar, me të drejtë ripërtëritje. **Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Tish Dahia, Pallati Eurobisnes, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I21029038M.

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME



**NENI 15**  
**TE DREJTAT DHE DETYRAT**

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit ;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kësaj pike ;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit ;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ;
- l) Për miratimin e marrjes së audituesve të jashtëm, në rastet e hetimeve të posacme;
- m) Miratimin e struktures së shoqërisë dhe nivelet e pagave për vend pune;
- n) Shpërndarjen e fitimeve për ortakët;
- o) Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
- p) Miratimin e marrjes së kredive bankare;
- q) Krijimin dhe përdorimin e fondit rezervë të shoqërisë;
- r) Shndërrimin e formës së shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërisë;
- s) Miratimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit e rregjistrimit të shoqërisë për rregjistrimin e vendimeve të shoqërisë, dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e tij;
- t) Miratimin e rregulloreve të ndryshme që në thelb kanë të bëjnë me procese të rëndësishme të veprimtarisë së shoqërisë ;
- u) Miratimin në rastin e shitblerjes së kuotave të ortakëve sipas parashikimeve të këtij statuti.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to , vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur





shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të kishte pasur dijeni për të .

#### NENI 16

#### MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqërite tregtare”, Nr. 9901, dt. 14.04.2008.
3. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme duhet thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
5. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorit.

#### NENI 17

#### THIRRJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë dhe/ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Materialet e mbledhjes të përcaktuara në rendin e ditës duhet të dërgohen jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga dita e caktuar për zhvillimin e mbledhjes, në formë elektronike dhe/ose me



shkresë të nënshkruara nga personat përgjegjës që i kanë përgatitur ato. Mosdërgimi i tyre në kohë konsiderohet si shkelje procedurës për thirrjen e asamblesë dhe mbledhja konsiderohet e pavlefshme, me përjashtim të rastit kur të gjithë ortakët janë dakord me mos zbatimin e kësaj dispozite.

3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **NENI 18 KUORUMI**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejte votë, që zotërojnë më shumë se 50 përqind të kuotave. Përjashtohen rastet kur në këtë statut parashikohet shprehimisht një shumicë më e vogël.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar, që parashikohen në nenin 87 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kuorumi i nevojshëm është ai i përcaktuar në nenin 19 të këtij statuti.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet, për shkak të mungesës së kuorunit në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 19 VENDIMET ME SHUMICE TE CILESUAR**

1. Asambleja merr vendim me  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e kuotave të të gjithë ortakëve të shoqërisë, në rastet e mëposhtme:
  - a) për ndryshimin e statutit,
  - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
  - c) shpërndarjen e fitimeve,
  - d) investimet;
  - e) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
  - f) për emërimin e ekspertit kontabël
  - g) për miratimin e marrjes së audituesve të jashtëm, në rastet e hetimeve të posacme
  - h) miratimin e marrjes së kredive bankare;
  - i) krijimin dhe përdorimin e fondit rezerve të shoqërisë;
  - j) shndërrimin e formës së shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërisë;
  - k) miratimin në rastin e shitblerjes së kuotave të ortakëve sipas parashikimeve të këtij statuti.

#### **NENI 20 MARRJA E VENDIMEVE NDAJ ORTAKEVE**



Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

## NENI 21 E DREJTA E VOTES

1. Cdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Ortakët, që nuk mund të jenë të pranishëm fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja e asamblesë së përgjithshme kanë të drejtë që të përfaqësohen, ose të marrin pjesë nëpërmjet, mjeteve të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet plotësisht identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
  - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve. Nëse gjatë zhvillimit të mbledhjes ndodh që të ndërpritet komunikimi mes ortakut/ve me mbledhjen për arsye teknike apo të forcave madhore, dhe ortaku apo ortakët nuk kanë përfaqësuesit e tyre fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja, atëherë vendimarrja do të konsiderohet e rregullt për aq kohë sa ishte vendosur lidhja e drejtpërdrejtë me mbledhjen me ortakun dhe/ose ortakët, gjë e cila duhet shënuar në procesverbalin e mbledhjes.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo ky statut, për të marrë unanimisht çdo vendim.

## NENI 22 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:



- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortakë përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakë, të cilin përfaqëson.

#### NENI 23

#### PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

#### NENI 24

#### HETIMET E POSAÇME

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës, i cili miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas parashkimeve të këtij statuti.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.
5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që



konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

6. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

## NENI 25

### SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TE PARREGULLTA DHE DEMSHPERBLIMI

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.
2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, ose një vlerë më të vogël të parashikuar në statut, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.
3. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.
4. Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.
5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacënuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.
6. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.
7. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" zbatohet edhe për këto padi.



**NENI 26**  
**TE DREJTAT E LIDHURA ME KUOTEN**

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 5 (pese) vjetëve nga çasti i cënimit.

**NENI 27**  
**NDALIMI I KUFIZIMEVE**

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.
2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cënojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

**ADMINISTRATORI**  
**NENI 28**  
**EMERIMI, SHKARKIMI, TE DREJTAT DHE DETYRIMET**

Asambleja e përgjithshme emëron **Z. Lorenc Xhepa**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.10.1982, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Tish Dahia, Pallati Eurobisnes, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I21029038M si administrator të shoqërisë.

1. Afati i emërimit, është për 5 ( pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e përgjithshme merr vendim e posacëm për riemërimin e administratorit pas periudhës së emërimit të parë. Emërimi i administratorit prodhon efekte vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Cdo vendim për ndryshimin e administratorit do të reflektohet automatikisht si një ndryshim i nenit 28 pika 1 e statutit.
3. Caktimi i Administratorit bëhet mbi bazën e kriterëve që duhet të ketë personi i zgjedhur administrator.
4. Administrator mund të emërohet njëri nga ortaket, dy ose më shumë prej tyre, dhe/ose një person jashtë shoqërisë që plotëson kriteret e vendosura nga asambleja e përgjithshme.
5. Në cdo rast administratori duhet të ketë një integritet të lartë moral dhe aftësi profesionale administruese të mira. Administratori që do përzgjidhet nga asambleja, dhe nuk është njëri prej ortakëve dhe/ose disa prej tyre duhet të ketë dorëzuar pranë shoqërisë dosjen e



dokumentacionit e cila, përfshin por pa u kufizuar në to, jetëshkrimin, dokumentin e identifikimit të noterizuar, diploma ose dokumenta të ngjashme, (origjinale ose të barazvlefshme me të) me të ku të provojë aftësitë e tij profesionale.

6. Asambleja e Përgjithshme nuk mund të emërojë si administrator të saj administratorin e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji. Gjithashtu, nuk mund të emërohen si administratorë, administratorët e një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
7. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
  - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhënie me të tretët;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) njoftoje ortakët për mbledhjen e shoqërisë me kërkesë të tij ose të njerit ose disa prej ortakëve;
  - e) mbajë një regjister të vecante ku të bëjë regjistrimin e të gjitha vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme. Të mbajë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që duhet për cdo mbledhje, përveç të tjerave, njoftimin për thirrjen e mbledhjes, procesverbalin dhe vendimin e asamblese të nënshkruar nga të gjithë ortakët pjesëmarrës, dhe dokumentat shoqëruese që janë diskutuar në mbledhje;
  - f) mbajë lidhje të ngushta me ortakët dhe të respektojë etiken në komunikim dhe marrëdhënie me ta.
  - g) lidhe kontratat e punës me punonjësit e shoqërisë;
  - h) mbajë korespondencë të rregullt me të tretët, si dhe të marrë të gjitha masat që kjo të jetë e arkivuar në arkivën e shoqërisë;
  - i) sigurojë akses të lirë dhe të pakushtëzuar për secilin prej ortakëve, që të njihet me cdo dokument që këta të fundit e vlerësojnë të rëndësishëm në mbarevajtjen e veprimtarisë së shoqërisë;
  - j) raportoje me shkrim ndaj asamblese së përgjithshme për veprimtarinë tremujore të shoqërisë, edhe nëse asambleja apo secili prej ortakëve nuk e ka kërkuar shprehimisht këtë raport. Ky raport duhet të dërgohet me shkrim dhe i nënshkruar nga administratori, zyrtarisht me postë dhe me postë elektronike, në adresë të ortakëve të shoqërisë. Ky raport midis të tjerash, por jo vetëm, duhet të përmbajë të dhëna financiare mbi gjendjen e shoqërisë që lidhen me : pagesat e punonjësve, pagesat periodike si taksat dhe tatimet, kështu e kredite, problemet e pazgjidhura, zbatimin e kontratave me të tretët, si dhe probleme të ndryshme teknike të veprimtarisë së shoqërisë, që administratori i gjykon të rëndësishme;
  - k) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;



- l) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - m) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - n) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - o) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut.
8. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme.
9. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Rregullat për ndarjen e veprimtarisë së administratorëve apo administrimin e përbashket të shoqërisë duhet të përcaktohen me një vendim të vecantë të asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Ky vendim duhet të përmbajë saktësimin e kompetencave dhe detyrave që u lihen secilit prej administratorëve. Ky vendim duhet të përmbajë, por pa u kufizuar në to, se cila do të jetë procedura dhe përgjegjësia e administratorëve në lidhje me veprimet financiare me bankat, me nënshkrimin e kontratave të punës, taksat dhe tatimet si dhe thirrjen e mbledhjes së asamblese së përgjithshme. Kuorumi i nevojshëm i asamblesë së ortakëve për të marrë këtë vendim duhet të jetë  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e kuotave të ortakëve pjesëmarrës. Pjesëmarrja e nevojshme për këtë vendim duhet të jetë shumica e thjeshtë. Ky vendim është i detyrueshëm për t'u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### **NENI 29 PERFAQESIMI**

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.
2. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **NENI 30 SHPERBLIMI**





1. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa. Shtesat bëhen me vendim të posacëm të asmblesë së ortakëve sipas nenit 86 të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit, gjendjen financiare të shoqërisë dhe të respektojë nivelet minimale të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### NENI 31

#### DETYRIMI I BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".këtij ligji;
  - dh) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.



4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen ortakëve kontributet;
- b) i paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) i shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 (tre) vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

## **KAPITULLI V**

### **PRISHJA E SHOQERISE**

#### **NENI 32**

#### **SHKAQET E PRISHJES SE SHOQERISE**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në statut;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

#### **NENI 33**

#### **REGJISTRIMI I SHPERBERJES**

1. Administratori ka detyrë të regjistrojë shpërbërjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim.
2. Në rastin e shpërberjes së shoqërisë, pavarësisht institucionit që ka marrë vendimin asamblesë dhe/ose gjykates, ngarkohet administratori që të kryejë procedurat deri në përfundim të këtij



procesi, për aq kohë sa, kjo dispozitë e statutit nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

## KAPITULLI VI

### LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

#### NENI 34

#### LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.
3. Administratori duhet të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të ketë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
5. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

#### NENI 35

#### PERJASHTIMI I ORTAKUT

1. Asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:
  - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
  - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
  - c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
  - ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të



përrjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përrjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përrjashtimin.

5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përrjashtim nuk është e bazuar.

6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përrjashtohet për shkak të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

#### **NENI 36**

#### **PASOJAT E LARGIMIT DHE PERJASHTIMIT**

1. Të gjitha të drejtat që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përrjashtimin.

2. Statuti nuk mund të përrjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përrjashtuar ortakun.

#### **NENI 37**

#### **LIKUIDIMI NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE**

Me përrjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

#### **NENI 38**

#### **PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqëria prishet kur :

1. Mbaron kohëzgjatja e parashikuar në aktin e themelimit dhe/ose në statutin e saj. Në cdo rast mospërputhje mes tyre, do të merret parasysh kohëzgjatja e parashikuar në statutin e datës së mëvonshme, nëse kohëzgjatja e shoqërisë ka ndryshuar me vendim të asamblesë së përgjithshme.
2. Me vendim të asamblesë së përgjithshme
3. Me hapjen e procedurave të falimentimit
4. Nëse shoqëria nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i saj, sipas pikës 3 të nenit 43 të Ligjit 9723 "Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit;
5. Me vendim të gjykatës;



6. Për cdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në këtë statut.

## KAPITULLI VII

### DISPOZITA TE FUNDIT

#### NENI 39

#### VLEFSHMERIA

Ky statut hyn në fuqi nga data e miratimit dhe regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### NENI 40

#### SIGURIA JURIDIKE

Gjithcka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të trajtohet sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe cdo bazë ligjore të parashikuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Palët e interesuara kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kompetente për cdo kundërshtim që kanë rreth aktivitetit të shoqërisë.

Ky statut u përpilua në dy kopje në gjuhën shqipe.

#### ORTAKET THEMELUES

**Lorenc Xhepa**

